REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 28/12 Data: 11.06.2012
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 28/12
Datë: 11.06.2012

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 01.06.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional - Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, 01.06.2012 deri 01.06.2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. **Asistent Administrativ; niveli i KKK-së: (III)**

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Harmonizimi dhe rishikimi i paketës mësimore dhe instrumenteve të vlerësimit bazuar në standardet profesionale. (Afati i realizimit: 01.06.2013)
- Rishikimi i kriterit hyrës për kandidatet në kualifikimin "Asistent Administrativ" për të krijuar mundësinë e kalimit në nivelin 4 të KKK-së. (Afati i realizimit: 01.06.2013)
- Certifikata të pajiset me pjesën shtesë ku përfshihen kompetencat e kandidatit, numri i kredisë dhe niveli ne KKK. (Afati i realizimit: 01.06.2013)
- Të avancohet me teknologjinë për inskenimin e rolit të asistentit administrativ (një stacion i punës). (Në vazhdimësi)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë:01.06.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

5.1. QRAP- Prishtinë;

5.2. AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjosha